



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A.

Nr. 306/1 prot.

Tiranë, më 14 . 02.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Kërkuesit: TV ORA NEWS

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr. 76 Ish –Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për informacion, rregjistruar me numër rendor. 1, datë 12.02.2025, Ju informojmë se:

1. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.1 "*Posta Shqiptare është ortakë në kompaninë celulare "ONE" Albania*"?
Ju bëjmë me dije se Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a, është aksionere e "ONE Albania" me vlerën 3.933.049 (tremilionenëntëqindetridhjetëetremijëedyzetenëntë) lekë dhe në masën 0.46 %.
2. Në përgjigje të pikës nr.2 "*A ka Posta Shqiptare anëtar bordi në "ONE Albania*"?
Ju bëjmë me dije se Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë herë anëtar bordi pranë "ONE Albania" vërtetuar kjo dhe nga Ekstrakti historik i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri Aksionere".
3. Në përgjigje të pikës nr.3 "*Në dy vitet e fundit përkatësisht 2023 dhe 2024 sa ka qenë fitimi që ka përfituar "Posta Shqiptare" nga "ONE Albania" si pjesë e ortakërisë.*"?
Ju bëjmë me dije se Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., nuk ka përfituar asnjë herë nga fitimet e kompanisë "One Albania" dhe konkretisht as në dy vitet e fundit në të cilën Ju keni përmëndur 2023 dhe 2024, vërtetuar kjo dhe në bilancet e Shoqërisë "Posta Shqiptare".
4. Në përgjigje të pikës nr.4 "*A është raportuar kjo vlerë në bilancet e Postës*"?
Ju bëjmë me dije se Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., nuk ka përfituar nga fitimi i "ONE Albania" dhe për këtë arsye nuk është as në bilancet e Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a.

Duke Ju falenderuar,

